



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

Nr.11 Prot.

Date, 21.02.2020

Miraturar me vendim Nr.5/21.02.2020 te Asamblese se pergjithshme te FSHQS

STEFAN RAVAJA

RREGULLORE E BRENDESHME E AKTIVITETEVE DHE E DISIPLINES

KAPITULLI I

DREJTIMI DHE ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE

Neni 1

Aktivitetet kombetare te qitjes sportive organizohen dhe drejtohen nga Federata Shqiptare e Qitjes Sportive ne bashkepunim me Shoqatat dhe Klubet Sportive ne rrethet ku zhvillohen keto aktivitete, mbi bazen e kalendarit sportiv kombetar vjetor te hartuar nga FSHQS.

Neni 2

Vendi , data, ora dhe menyra e zhvillimit te çdo aktiviteti percaktohet ne Kalendarin Sportiv , ne perputhje me strukturen organizative te miraturar nga Komiteti Drejtues i FSHQS.



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

*Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189*

*Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com*

Neni 3

Kalendari Sportiv Kombetar eshte i detyrueshem te zbatohet nga te gjitha ekipet e qitjes. Ai mund te ndryshohet nga kryesia e FSHQS vetem ne raste te jashtezakonshme te cilat nuk mund te parashikohen me pare.

Neni 4

Te gjitha aktivitetet kombetare zyrtare si per te rritur ashtu dhe per te rinj do te zhvillohen detyrimisht ne poligonet e miratuara per qitje sportive te cilat jane : Tirana, Studenti, Vlora

Neni 5

Klubet sportive te cilat jane percaktuar ne kalendarin kombetar per te zhvilluar aktivitetet e qitjes dhe per arsye madhore nuk mund te zhvillojne ate ne kohen e percaktuar, duhet te njoftojne Federaten 20 dite perpara zhvillimit te aktivitetit.

Neni 6

Programi i zhvillimit te garave per cdo aktivitet kombetar hartohet nga FSHQS dhe u komunikohet klubeve dhe ekipeve pjemarrese jo me vone se 7 dite perpara fillimit te aktivitetit te planifikuar.

Neni 7

Ne rastet kur nje aktivitet kombetar nuk mund te zhvillohet ne vendin ose daten e caktuar ne kalendarin sportiv, te drejten e ricaktimit te dates dhe vendit per zhvillimin e atij aktiviteti e ka Komiteti Drejtues i FSHQS i cila merr masa per njoftimin ne kohe te ketij ndryshimi.

Neni 8

Per pergatitjen e poligonit te qitjes per gare si dhe te bazes se nevojshme materiale teknike per zhvillimin normal te aktivitetit pergjigjet klubi sportiv perkates i cili ne bashkepunim me Federaten duhet ti kete ne gadishmeri 1 jave perpara fillimit te aktivitetit.



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

*Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189*

*Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com*

Neni 9

Ne infrastrukturen e poligoneve ku do te zhvillohen garat e aktivitetit kombetar duhet te perfshihen dhe paisjet (Flamuri kombetar, flamuri i Klubit dhe Federates, ore e madhe e poligonit, tabela e pikeve etj.)

Neni 10

Te gjithe poligonet, krahas disponimit te paisjeve te nevojshme per zhvillimin normal te garave, duhet te kene dhe dhoma zhveshje dhe ambjente normale hidrosanitare per ekipet pjesemarrrese si dhe dhomen e punes per Gjyqtarine.

Neni 11

Klubi prites (ku zhvillohet aktiviteti) duhet te marre masat per te siguruar prezencen e organeve te ruajtjes se rendit si dhe te mjekut gjate gjithe kohes se zhvillimit te aktivitetit.

Neni 12

Ekipet dhe sportistet pjesemarrres ne aktivitetet kombetare, transportimin e armeve dhe municioneve nga nje rreth ne tjetrin duhet ta bejne vetem me automjete ne dispozicion. Ndalohet transportimi i tyre me mjete urbane (autobuze ose tren).

Neni 13

Armet dhe municionet sportive gjate zhvillimit te aktiviteve kombetare te qitjes mbahen vetem ne depot e armatimit te poligonit ku zhvillohet aktiviteti. Mbajtja e armeve dhe municionit jashte depove te armatimit, ne hotele etj, eshte e ndaluar dhe penalizohet sipas ligjit.

Neni 14

Ne fillim dhe ne perfundim te cdo aktiviteti do te zhvillohet ceremonia e hapjes dhe ajo e mbyljes ku dorezohen diplomat, medaljet dhe kupat e fituesve. Ekipet jane te detyruar te marrin pjese me te



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

gjithe pjesmarresit e regjistruar ne protokollin e garave. Ekipi ose sportisti qe ka zene vend nderi ne aktivitetin kombetar, nuk merr pjese ne ceremonine e dorezimit te diplomave pa arsye skualifikohet.

Neni 15

Per fituesit e aktiviteteteve kombetare FSHQS jep vleresime morale e materiale :

Ekipit fituesi i jepet kupe dhe diplome, ekipeve te vendit te dyte dhe te trete u jepen diploma. Qitesve qe renditen nga vendi i pare der tek i treti per çdo lloj ushtrimi u jepen diploma. Qitesit qe ne kampionatin individual klasifikohen ne vendin e pare per çdo ushtrim u jepet diplome dhe medalje kampioni

KAPITULLI II

PJESMARRJA DHE AKTIVIZIMI

Neni 1

Ne aktivitetet kombetare zyrtare te qitjes sportive marrin pjese ekipet e klubeve dhe sportistet e tyre te cilet jane regjistruar e licensuar nga FSHQS.

Neni 2

Regjistrimi dhe licensimi i klubeve, shoqatave dhe sportisteve per pjesmarrje ne aktivitetet kombetare dhe nderkombetare te qitjes sportive do te behet brenda muajit shkurt te cdo viti.

Neni 3

Cdo klub sportive dhe shoqate regjistrohet duke plotesuar formularin e regjistrimit te aprovuar nga FSHQS.

Neni 4

Cdo klub sportiv , ose shoqate pervec Listes se Federimit duhet te dergoje ne FSHQS dhe pagesen e licensimit per ekipin dhe cdo trainer e sportist antar. Per cdo license do te paguhet vlere e percaktuar



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

*Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189*

*Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com*

nga Asambleja e Pergjithshme e Federates. Klubet sportive dhe shoqatat anetare qe nuk bejne licensimin ne kohen e duhur nuk kane te drejte te marrin pjese ne aktivitetet kombetare e nderkombetare.

Neni 5

Ne aktivitetet zyrtare kombetare dhe nderkombetare (zyrtare ose miqsore) marrin pjese vetem trajneret, sportistet dhe gjyqtaret qe kane qendrim te mire moral dhe qe njohin e zbatojne rregullat e sigurimit teknik te qitjes.

Neni 6

Traineret dhe sportistet te cilet kane masa disiplinore te marra nga klubi i tyre sportiv dhe kur Federata eshte njoftuar per keto masa, nuk do te lejohen te marrin pjese ne aktivitetin kombetar e nderkombetar.

Neni 7

Federimi i sportisteve sipas kategorive te moshes (te rritur e te rinj) behet konform Rregullores teknike te qitjes sportive. Sportist i ri quhet qitesi i moshes deri 21 vjeç.

Neni 8

Llogaritja e moshes behet me vitin kalendarik kur zhvillohet aktiviteti dhe jo me muajin e lindjes (Pra nese nje qites i aktivizuar me te rinjte mbush moshen 21 vjec ne muajin mars, lejohet te marre pjese me te rinjte deri ne dhjetor te atij viti).

Neni 9

Listat e federimeve te sportisteve pjesmarres do te paraqiten nga ekipet prane Sekretarit te Pergjithshem te Federates per çdo aktivitet, 24 ore para para fillimit te tij. Liste federimi duhet te permbaje te dhenat : Emri Mbiemri, datelindja, atesia, vendlindja, ushtrimi qe do te konkuroje. Per vertetesine e plotesimit te listes se federimit mban pergjegjesi drejtuesi i klubit sportiv , ose shoqates



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

*Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189*

*Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com*

si dhe drejtuesi i ekipit te cilet duhet ta vertetojne ate duke e firmosur e vulosur. Neqoftese ka pasaktesi ne plotesimin e list-federimit, ekipi ose sportisti me mangesi nuk do te lejohen te aktivizohen ne ate aktivitet.

Neni 10

Qitesat e rinj lejohen te marrin pjese ne aktivitetet e te rriturve, pa humbur te drejten e aktivizimit me ekipin e te rinjve dhe brenda vitit, pervec Kampjonatit Kombetar.

Neni 11

Ne aktivitetet kombetare qitesi lejohet te marre pjese vetem ne dy lloj ushtrimi te nje arme (pushke ose pistolete). Nuk lejohet qe nje qites te marre pjese ne nje ushtrim te qitjes me pushke dhe ne nje ushtrim te qitjes me pistolete

Neni 12

Traineret e ekipeve lejohen te aktivizohen si qitesa ne aktivitetet kombetare te qitjes kur ata federohen si te tille ne fillim te vitit

KAPITULLI III

TRANSFERIMI I SPORTISTEVE

Neni 1

Te gjithë antaret e Federates se Qitjes, ne perberje te klubit sportiv qe ata zgjedhin, kane te drejte te marrin pjese ne stervitje dhe aktivitetet kombetare e nderkombetare te ketij sporti.

Neni 2

Veprimtaria e anetarit te nje klubi apo shoqate (sportistit, trainerit etj.) ne marrdhenie me klubin sportiv duhet te bazohet me Kontraten e lidhur ndermjet tyre. Kopjet te kontratave te lidhura duhet



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

te depozitohen ne çdo fillim viti ne Federate, mbasi ato te jene plotesuar sipas Legjislacionit Shqiptar.

Neni 3

Cdo antar i nje klubi/shoqate ka te drejten te ndryshoje antaresine e tij nga nje klub ne tjetrin, por levizja e sportisteve dhe trainereve do te behet vetem nepermjet kontrates dhe kushteve te percaktuara me pare ne te. Asnje nuk ka te drejte te lidhe nje kontrate me nje klub tjetër sportiv pa perfunduar kontrata qe ai ka ne fuqi me klubin e tij.

Neni 4

Transferimi i sportisteve nga nje klub ne tjetrin behet mbi bazen e mareveshjes ndermjet dy klubeve dhe deshires se sportistit ne perputhje me kontraten perkatese.

Neni 5

Nje sportist i aktivizuar ose transferuar ne nje klub nuk ka te drejte te aktivizohet me nje klub tjetër ose te kthehet ne klubin e meparshem brenda vitit kalendarik. Ne cdo rasti sportisti do bej njoftimin ne Federate per ndryshimin e ekipit, por nuk ka te drejte te marre pjese ne gare me ekipin e ri deri ne fund te vitit kalendarit. Ndryshimet aplikohen dhe hyjne ne fuqi cdo fillim viti kalendarik.

Neni 6

Ne rast te konflikteve ndermjet dy klubeve sportive per aktivizimin e nje sportisti dhe kur kontratat kane perfunduar, ose muk ka fare te tilla, vendimi perfundimtar do te merret sipas deshires se vete sportistit i cili duhet te paraqese ate ne Federate.

Neni 7

Konfliktet qe rrjedhin lidhur me respektimin e kontratave ndermjet paleve qe e kane nenshkruar ate, kur nuk gjejne zgjidhjen e arsyshme, do te zgjidhen sipas Ligjit per Sportin , ne Gjykatën Sportive



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

(KAS). Ne rast se nuk ka kontrata si e tille konsiderohet lista e federimit e dorezuar ne fillim te vitit ne Federate konfirmuar me firme dhe vule nga drejtuesi shoqates ose i klubit dhe konfirmuar nga secili sportist.

KAPITULLI IV

GJYQTARET, PJESMARRJA DHE AKTIVIZIMI

Neni 1

Ne aktivitetet kombetare zyrtare te qitjes sportive gjykojne gjyqtare te cilet jane regjistruar e licensuar dhe kategorizuar nga FSHQS.

Neni 2

Regjistrimi dhe licensimi i gjyqtareve kombetar per pjesmarrje ne aktivitetet kombetare te qitjes sportive do te behet brenda muajit shkurt te cdo viti, se bashku me licensimet e klubeve.

Neni 3

Cdo klub sportiv regjistrohet duke plotesuar formularin e regjistrimit te aprovuar nga FSHQS.

Neni 4

Cdo gjyqtar ne perberje te klubit, shoqates ose dhe individualisht pervec listes se federimit duhet te dergoje ne FSHQS dhe pagesen e licensimit si antar. Per cdo license do te paguhet vlere e percaktuar nga Asambleja e Pergjithshme e Federates. Gjyqtaret qe nuk bejne licensimin ne kohen e duhur nuk kane te drejte te marrin pjese ne aktivitetet kombetare

Neni 5

Ne aktivitetet zyrtare kombetare (zyrtare ose miqsore) marrin pjese vetem gjyqtaret, qe kane qendrim te mire moral dhe qe njohin e zbatojne rregulloren e sigurimit teknik te qitjes.



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

*Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189*

*Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com*

Neni 6

Gjyqtaret te cilet kane masa disiplinore, nuk do te lejohen te marrin pjese ne aktivitetin kombetar.

Neni 7

Caktimi i numrit te gjyqtareve dhe aktivizimi i tyre ne aktivitetet kombetare sipas kategorive te moshes (te rritur e te rinj) behet konform Rregullores Teknike Nderkombetare te Qitjes Sportive.

Neni 8

Caktimi i Kryegjyqtarit i Kryesekretarit dhe gjyqtareve te tjere behet nga Sekretari I Pergjithshem I Federates ne bashkepunim me Keshillin e Gjyqtareve, mbeshtetur ne kete Rregullore, ne kategorite e tyre si dhe ne kompetencen e gjykimit ne aktivitetet e zhvilluara ne cdo vit kalendarik, duke pasur parasysh ne aktivizimin e tyre si dhe rregullin e gjithperfshirjes dhe te barazise.

Neni 9

Gjyqtaret e licensuar prane FSHQS jane te detyruar te marrin pjese ne te gjitha seminaret dhe kurset e kualifikimit te organizuara nga kjo Federate, per ngritjen e tyre profesionale si dhe njohjen me rregullat e reja (kombetare dhe nderkombetare).

Neni 10

Ne aktivitetet kombetare ne cdo veprim gjyqtari do te mbeshtetet rigorozisht ne Rregulloren Teknike Nderkombetare te zhvillimit te garave te qitjes duke mbajtur pergjegjesi per zbatimin e saj.

Neni 11

Kur gjyqtaret shkelin rregulloren marrin masa disiplinore te percaktuara ne Kapitullin VI –te te kesaj Rregullore, neni 1.4.



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

KAPITULLI V

KLASIFIKIMI

Neni 1.

Ne aktivitetet kombetare te qitjes sportive te cilat shpallen çdo fillim viti ne kalendarin sportiv kombetar, nder te tjera percaktohet dhe menyra e klasifikimit per cdo aktivitet.

Neni 2

Ne aktivitetet kombetare si per te rritur e te rinj do te kete klasifikim ekipor dhe individual.

Neni 3

Ky klasifikim do te jete veç per meshkuj dhe veç per femra dhe i vecante sipas llojit te armes (pushke e pistolete).

Neni 4

Klasifikimi individual dhe ekipor ne aktivitetet kombetare te qitjes sportive behet mbeshetur ne Rregulloren Teknike (pra mbi shumen e pikeve te mbledhura nga cdo individ ne ushtrimin perkates si dhe shuma e pikeve te individeve ne perberje te ekipit).

Ne qoftese ne aktivitetet kombetare do te zhvillohet gara finale, klasifikimi do te behen mbi piket e grumbulluara sipas Rregullores.

Neni 5

Klasifikimi ekipor behet me tre sportiste te cilet percaktohen para fillimit te gares nga klubi ose shoqate , ne listen e sportisteve qe jepen per regjistrim ne gare.

Neni 6

Klasifikimi vjetor individual behet mbi bazen e 6 garave baze te kalendarit te Federates , duke marre mesataren e pikeve mbi piket totale te ketyre garave .



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

Neni 7

Per llogaritjen e klasifikimit te sportistevqe qe jetojne jashte shtetit do te kerkohe me detyrim te marrin pjese ne tre gara nga kalendari vjetor i FSHQS , ku nje nga keto gara duhet te jete patjeter Kampjonati Kombetar, ndersa tre gara te tjera do te jen pjesemarrje ne gara jashte shtetit.Sportisti duhet te njoftoje ne fillim te vitit per kalendarin e garave ku do te marre pjese dhe Federata do te zgjedhe garat ne datat e peraferta me ato te kalendarit kombetar.

Neni 8

Do te kete prioritete ne klasifikim e sportistevqe duke marre parasysh renditjen ne listen e rakimit boteror.

Neni 9

Sportistet qe do te marrin pjese garen e 12 sportistevqe me te mire te vitit , jashte gare, do te kete nje tarife qe do te caktohet nga Komiteti Drejtues.

KAPITULLI VI

MASAT DISIPLINORE TE DREJTAT DHE DETYRAT E ANTAREVE

Neni 1

Te gjitha antaret e regjistruar prane FSHQS ku perfshihen Klubet, Shoqatat Sportive te Qitjes, antaret e tyre si dhe gjithe personat e tjere qe perfshihen ne strukturat dhe aktivitetet zyrtare te FSHQS kane te drejte dhe jane te detyruar te njohin dhe te zbatojne te gjitha vendimet e parashikuara ne kete Rregullore.

Neni 2

Personat dhe subjektet qe mund te behen objekt denimesh ne rast shkeljesh jane : Ekipet e Klubeve dhe shoqatave sportive, drejtuesit dhe traineret e tyre, sportistet, gjyqtaret si dhe persona te tjere te cilet aktivizohen ne aktivitetet kombetare te qitjes sportive.



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

*Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189*

*Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com*

Neni 3

Klubet dhe shoqatat sportive jene pergjegjes per menyren jo te hijshme te sjelljeve per te gjithë personat antare te tyre qe prezantojne ato ne aktivitetet sportive kombetare.

Neni 4

Sportistet qe marrin pjese ne aktivitetet kombetare te qitjes sportive duhet te njohin dhe zbatojne me rreptesi Rregulloren Teknike te qitjes sportive,ne te kunderten ndaj tyre merren masat qe percakton Rregullorja teknike dhe ajo e brendeshme e FSHQS.

KAPITULLI VI

ORGANET KOMPETENTE PER DHENIEN E DENIMEVE

Neni 1.

Organet per marrjen dhe dhenien e vendimeve te masave disiplinore jane :

- Asambleja e Pergjithshme
- Komiteti Drejtues i FSHQS

Neni 2

Organi me i larte gjyqsor i FSHQS eshte Komisioni i Arbitrazhit Sportiv (K.A.S) i cili funksion prane KOKSH. Ky Komision pranon, shqyrton dhe jep vendimin perfundimtar ne rast ankesash per vendime te padrejta te marra nga FSHQS ndaj antareve te saj. Vendimi I KAS – it eshte perfundimtar dhe i pa apelushem.

Neni 3

Asambleja e Pergjithshme mund te marre masa disiplinore per Klubet, Shoqatat sportive si dhe per individë te veçante duke dhene ne veresi te shkeljeve, denimet per perjashtim nga 1 vit deri pergjithmone nga aktivitetet kombetare dhe nderkombetare te qitjes.



FEDERATA SHQIPTARE E QITJES SPORTIVE ALBANIAN SHOOTING SPORT FEDERATION

Parku Olimpik, Rruga Liman Kaba
Tel. Fax : + 355 4 5628189

Tirane - Albania- Postal Code 1001
email : Albaniashooting@yahoo.com

Neni 4

Komiteti Drejtues i FSHQS është organi kompetent i gjykimit në shkallën e parë dhe ka kompetencën të analizojë të gjykojë dhe të marrë masat përkatëse për shkeljet e bërë nga antaret e saj. Ai mund të japë vendimet e mëposhtme :

- Paralajmerime
- Pezullim dhe përjashtim deri një vit nga aktivitetet kombëtare dhe nderkombëtare të trenerëve, gjyqtarëve dhe sportistëve.
- Ulje në kategori të gjyqtarëve dhe trenerëve
- Vlerësimin dhe analizimin e protestave dhe reklamimeve që janë paraqitur nga individët dhe ekipet gjatë aktivitetit zyrtar dhe që nuk ka marrë përgjigje të drejte nga gjyqtaria

KAPITULLI I VII

LLOJET E USHTRIMEVE TE QITJES

Neni 1.1 Ushtrimet që do të zhvillohen në aktivitetet kombëtare të qitjes sportive **per te rritur** meshkuj e femra, modeli i armëve si dhe numuri i pjesëmarrësve për çdo ushtrim për klasifikimin ekipor do të jete si më poshtë :

- | | | | |
|-----------------|--------|---|-----------|
| - Pushke ajer | 1 x 60 | - | 3 femra |
| - Pushke ajer | 1 x 60 | - | 3 meshkuj |
| - Pistolet ajer | 1 x 60 | - | 3 femra |
| - Pistolet ajer | 1 x 60 | - | 3 meshkuj |

1.2 Ushtrimet që do të zhvillohen në aktivitetet kombëtare të qitjes **per te rinj** meshkuj e femra, modeli I armëve si dhe numuri I pjesëmarrësve për çdo ushtrim për klasifikimin ekipor do të jete si më poshtë :

- | | | | |
|-----------------|--------|---|-----------|
| - Pistolet ajer | 1 x 60 | - | 2 femra |
| - Pistolet ajer | 1 x 60 | - | 2 meshkuj |
| - Pushke ajer | 1 x 60 | - | 2 femra |
| - Pushke ajer | 1 x 60 | - | 2 meshkuj |